V E N D I M
Nr.689, datë 13.12.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E ZALL-HERRIT (BATHORE)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Zall-Herrit (Bathore).
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Zall-Herrit (Bathore).
3. Pronarët e pasurive së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 12700 m2 tokë bujqësore, në shumën e përgjithshme prej 10 160 000 (dhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit
5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Komunës së Zall-Herrit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekë.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 14 deri në 31 dhjetor 2001.
7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Zall-Herrit.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE
NË KOMUNËN E ZALL-HERRIT

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Hajdar Ibrahim Allushi	4700	800	3760000
2	Sadik Ibrahim Allushi	4000	800	3200000
3	Qamil Mustafa Fejza	4000	800	3200000
	Shuma	12700		10160000